



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 19
Prishtinë, më 14 shtator 2015, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala C-203

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Enver Hoxhaj, Qerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Elmi Reçica, Puhie Demaku dhe Zafir Berisha.

Munguan: Ismet Beqiri, Teuta Rugova, Ramush Haradinaj.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi.

Pjesëmarrës të tjerë: Sanije Berisha – OSBE, Lumnije Murati – ZPRK; Mërgime Kajtazi – KDI, Gurjeta Zeka – LVV dhe media.

Mbledhjen e kryesoi: Enver Hoxhaj, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Formimi i grupeve të miqësisë;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Formimi i grupeve të miqësisë;

Enver Hoxhaj njoftoi se Kryesia e Kuvendit, ka propozuar formimin e grupeve të miqësisë me parlamentet e vendeve të tjera dhe në këtë drejtim deputetët nga grupet parlamentare janë deklaruar për përfaqësimin e tyre në grupe të miqësisë. Përkrahu listën e propozuar për formimin e grupeve të miqësisë dhe propozoi që në këtë listë të përfshihet edhe kriteri politik, duke e plotësuar me vendet të cilat nuk e kanë njohur Kosovën, por që kanë peshë ndërkombëtare për të ardhmen e saj si Kina,

Brazili, India e grupi i shteteve të G-20. Po ashtu kriter tjetër në formimin e grupeve të miqësisë do të duhej të merret parasysh, kriteri gjeografik dhe ai gjuhësor dhe se me çfarë çelësi do të duhej të formoheshin këto grupe, tha z. Hoxhaj.

Zafir Berisha tha se formimi i grupeve të miqësisë është çështje formale por megjithatë është shumë i rëndësishëm. Propozoi që të formohen grupe të miqësisë edhe me vende që nuk e kanë njohur Kosovën, e edhe me Serbinë. Theksoi se për formimin e grupeve të miqësisë me disa shtete ka pak deputetë të deklaruar si p.sh. me Rumaninë, ndërsa kryesues të grupit të miqësisë me Shqipërinë, propozoi të jetë përfaqësuesi i GP-Nisma. Përkrahu propozimet për formimin e grupeve të miqësisë për të cilat propozoi që të plotësohen aty ku është e nevojshme.

Puhie Demaku sa i përket listave të grupit të miqësisë, theksoi se në disa prej tyre ka një koncentrim të tejkaluar të deputetëve, ndërsa në disa të tjera ka një koncentrim të mangët, gjë që është potencuar në pikën 2 e 3 të draft-propozimit. Tha se pajtohet me z. Hoxhaj, se duhet të shtohen edhe grupe të tjera të miqësisë me vende të tjera të interesit, ndërsa sa i përket çelësit politik në formimin e tyre, nuk duhet të reflektoj forca politike që ekziston brenda parlamentit, por në çdo grup të miqësisë të jenë nga një apo dy deputetë nga secili subjekt politik.

Blerta Deliu Kodra njoftoi se z. Ismet Beqiri ka kërkuar që lista e grupeve të miqësisë të plotësohet edhe me disa deputetë nga GP-LDK-së, të cilët nuk figurojnë në listë. Theksoi se ne kemi dëshirë e vullnet të krijojmë grupe të miqësisë me shtetet që nuk na kanë njohur, por si do të ndodhë me shtetin e Spanjës i cili nuk ka ndonjë bashkëpunim ndër parlamentar me ne. Po ashtu theksoi faktin se në disa grupe të miqësisë ka të paraqitur vetëm nga një apo dy deputetë dhe nuk ka përbërje politike ndërsa në disa grupe të miqësisë është fokusim i madh i deputetëve.

Elmi Reçica theksoi se jemi vonuar në themelimin e grupeve të miqësisë dhe se formimi i tyre është rruga më e mirë për të komunikuar me parlamentet si motra. Duke pasur parasysh se grupet e propozuara të miqësisë nuk janë të plotësuara dhe disa prej tyre kanë vetëm nga një apo dy deputetë, tha se do të ishte mirë që ato t'i plotësojmë me propozime konkrete. Interesimi ynë është që grupet e miqësisë të jenë funksionale, të lënë gjurmë dhe të ofrohemi me shtete të caktuara me të cilat nuk jemi edhe aq prezent, tha z. Reçica. Listat ku nuk kemi deputetë të mjaftueshëm për grupe të miqësisë tha se duhet të diskutohet, që të plotësohen.

Qerim Bajrami propozoi që lista e grupeve të miqësisë të shqyrtohet edhe njëherë sepse ka lëshime, deputeti Danush Ademi nuk figuron në asnjë grup të miqësisë edhe pse ai është paraqitur të jetë anëtarë i grupeve të miqësisë. Duke pasur parasysh propozimet e anëtarëve të Komisionit për formimin e grupeve të miqësisë me vendet që nuk na kanë njohur, propozoi të formohet edhe grupi i miqësisë me Bosnjën.

Enver Hoxhaj bazuar në diskutimet e anëtarëve të Komisionit, theksoi se u parashtrua nevoja që listat e grupeve të miqësisë të rishqyrtohen dhe të plotësohen. Theksoi se nga Amerika Latine nuk kemi asnjë shtet të propozuar për formimin e grupeve të miqësisë e po ashtu edhe nga Azia është propozuar formimi i grupeve të miqësisë vetëm me Japoninë dhe Malajzinë. Ai tha se ka edhe deputetë të cilët nuk janë të përfaqësuar si dhe në disa grupe të miqësisë ka një koncentrim më të madh të deputetëve e në disa nuk ka. Propozoi që në Komision të përcillen propozime plotësuese për formimin e grupeve të miqësisë dhe Komisioni të takohet të hënën dhe ta shqyrtoj secilin grup të miqësisë veç e veç. Z. Hoxhaj theksoi se është për një qasje më të plotë dhe gjeografike lidhur me formimin e grupeve të miqësisë.

Pas diskutimeve lidhur me formimin e grupeve të miqësisë Kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë

P ë r f u n d i m

Formimi i grupeve të miqësisë në mes të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe deputetëve të parlamenteve të vendeve të tjera, të shqyrtohet në mbledhjen e radhës së Komisionit, me propozimet plotësuese nga anëtarët e Komisionit.

4. Të ndryshme.

Anëtarët e Komisionit, shqyrtuan raportet nga dëgjimi i kandidatëve të propozuar për ambasadorë, nga takimet mbajtura më dt. 9 e 10 shtator 2015, dhe të njëjtat u miratuan për procedim të mëtutjeshëm.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Enver Hoxhaj